



GRATË NË PROGRAMET E PARTIVE KRYESORE POLITIKE

Raport Monitorimi

Prill 2021

Ky botim u përgatit përmes projektit "Zgjedhje Gjithëpërfshirëse" të financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Pikëpamjet dhe përmbajtja e tij janë të autorit.



Autoret

Ines Leskaj

Irena Shtraza

@Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, Tiranë, Prill 2021



PËRMBAJTJE

QËLLIMI I RAPORTIT	4
PSE INTEGRIM GJINOR NË PROGRAMET PARTIAKE?	4
GJETJE KRYESORE TË MONITORIMIT	5
PUBLIKIMI I PROGRAMEVE PARTIAKE.....	6
VLERËSIMI I PROGRAMEVE POLITIKE DHE FOKUSI I TYRE PËR GRATË	7
Lëvizja Socialiste për Integrim	7
Partia Demokratike e Shqipërisë.....	9
Partia Socialiste e Shqipërisë.....	11
Nisma Thurje	13
FORCAT POLITIKE DHE GRATË PËRGJATË FUSHATËS ELEKTORALE	14
PËRFUNDIME	15

QËLLIMI I RAPORTIT

Ky raport monitorues do të analizojë programet politike të partive kryesore në vend nga pikëpamja gjinore: Partisë Socialiste (PS), Koalicionit "Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim" (PD-AN), Lëvizjes Socialiste për Integritet (LSI), si dhe forcës së re politike të regjistruar për herë të parë në zgjedhje parlamentare 'Nisma Thurje'. Monitorimi është kryer gjatë një periudhë kohore prej 2.5 muajsh nga 1 shkurt deri 15 prill 2021.

Qëllimi kryesor i analizës është që të vlerësojë fokusin që i është dhënë planeve për fuqizimin dhe përfshirjen e grave dhe vajzave në të gjithë sektorët që këto parti synojnë të zhvillojnë gjatë udhëheqjes së tyre si forca politike. Një synim tjetër i raportit lidhet me vlerësimin dhe analizën nëse janë përdorur qasje dhe strategji të integritetit gjinor nga partitë politik përgjatë programeve për katërvjeçarin e ardhshëm.

Analiza është gjithashtu një mjet i nevojshëm për t'u përdorur për informim, sensibilizim e ndërgjegjësim të grupeve të ndryshme të popullatës lidhur me rëndësinë e qasjes së integritetit gjinor dhe gjithëpërfshirjes sociale si çështje themelore e të drejtave të njeriut.

Një objektivi final i kësaj analize është të vlerësojë përgjegjshmërinë e forcave kryesore politike ngaj zgjedhësve të tyre, duke vlerësuar se publikimi në kohë dhe i plotë i propozimeve zgjedhore është një tregues parësor e thelbësor.

Dokumente që u përdorën për hartimin e këtij raporti janë:

- Programet e partive të publikuara në faqet e tyre zyrtare;
- Artikuj lidhur me programet partiake të publikuara në media të ndryshme online;
- Informacion i marrë nga persona të intervistuar nga forcat politike të marra në analizë.

PSE INTEGRIM GJINOR NË PROGRAMET PARTIAKE?

Angazhimi i partive politike sa i takon rolit dhe përfshirjes së grave dhe arritjes së barazisë gjinore mund të tregohet më së miri nëpërmjet artikullimit të normave, objektivave apo planeve afatgjatë në dokumente të rëndësishme siç mund të jenë: statuti, rregulloret e brendshme, listat shumë-emërore të kandidatëve për deputetë/e, si dhe programet e tyre politike. Këto janë hapa të rëndësishëm që influencojnë sistemet, praktikën dhe kulturën brenda partive.

Zgjedhjet parlamentare në jetën e çdo qytetareje dhe qytetari të Republikës së Shqipërisë janë moment tepër i rëndësishëm. Ato/ata që votojnë për një përfaqësim sa më të denjë të interesave publike duhet të jenë po aq të rëndësishëm për partitë politike që operojnë në

vendin tonë. Siç ndodh rëndom në vendet demokratike dhe të pavarura, edhe në Shqipëri programet e partive politike marrin rëndësi të veçantë sidomos në periudhën parazgjedhore. Për këtë arsye, identifikimi dhe adresimi i problematikave që përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetareve dhe qytetarëve të vendit, posaçërisht atyre më pak të favorizuar, duhet të jetë pjesë qendrore e ofertës politike të secilit subjekt zgjedhor gjatë kësaj gare elektorale.

GJETJE KRYESORE TË MONITORIMIT

- Një problematikë kryesore e vënë re ka qenë mungesa e programeve e dy partive kryesore në zgjedhje, PS dhe PD, deri në fund të muajit Mars 2021. Thirrjet publike dhe kërkesat zyrtare drejtuar nga AWEN drejt këtyre partive nuk kanë marrë përgjigje dhe deri më tani nuk ka patur publikime të plota të programeve të këtyre dy forcave politike.
- PS ka bërë publike fushat proritare nëpërmjet një konference për shtyp, si dhe nëpërmjet publikimit të këtyre fushave në disa media audio-vizive dhe të shkruara. Kryetari i PS, njëkohësisht edhe kryeministër i vendit është shprehur në media se PS nuk ka një program por një plan veprimi, që është vazhdim i programit qeverisës gjatë 8-vjeçarit që PS ka drejtuar vendin.
- PD, gjatë muajit prill ka paraqitur gjithashtu në faqen zyrtare, si edhe në fjalime të kryetarit të partisë fushat kryesore të programit.
- Dy partitë e tjera, LSI dhe Nisma Thurje i kanë publikuar programet e përmbledhura sipas fushave në faqet e tyre zyrtare që në krye të fushatës elektorale.
- Gratë dhe barazia gjinore janë pjesë integrale e programit të LSI, e cila e ka vendosur gruan paralelisht në të gjitha ndërhyrjet dhe fushat prioritare.
- Nisma Thurje ka një qasje të unifikuar për të gjithë qytetarët, pa veçuar nisma specifike për gratë apo barazinë gjinore.
- Dy forcat kryesore politike të vendit, PD dhe PS kanë prekur/përmendur gjatë pjesës së parë të fushatës vetëm pjesërisht dhe jo thelbësisht gruan dhe çështjet e barazisë gjinore. Vetëm pas javës së parë të muajit prill, gratë dhe fuqizimi i tyre duket se janë bërë pjesë prioritare e propozimit të PD-së. Në paraqitjen e programit, i kushtohet një seksion i veçantë me natyrë gjithëpërfshirëse dhe ndërsektoriale problematikave të grave dhe çështjes së barazisë gjinore.

Në asnjë nga programet nuk është theksuar apo përcaktuar se si do të bëhet menaxhimi i situatës së krijuar si rezultat i pandemisë, ndikimit që ajo ka patur tek familjet, veçanërisht gratë, krizat sociale dhe ekonomike të shkaktuara prej saj.

PUBLIKIMI I PROGRAMEVE PARTIAKE

Një objektivi i kësaj analize është të vlerësojë përgjegjshmërinë e forcave kryesore politike në vend ndaj zgjedhësve të tyre, duke vlerësuar se publikimi në kohë dhe i plotë i propozimeve zgjedhore është një tregues parësor e thelbësor.

Një nga sfidat kryesore të këtij procesi monitorimi ka qenë mungesa e programeve partiake të dy prej partive kryesore në vend PD dhe PS, nga katër që janë subjekt i kësaj analize. Kjo mungesë është vënë re përgjatë gjithë pjesës së parë të fushatës ku përfshihet edhe fillimi i muajit prill 2021. Megjithë thirrjet publike dhe kërkesave zyrtare drejtuar këtyre partive nga AWEN, ende nuk ka patur publikime të plota të programeve partiake, pavarësisht se këto janë dy forcat politike më të mëdha në vend që garojnë në këto zgjedhje parlamentare. Përfaqësues të këtyre dy partive kanë komunikuar se nuk ka programe përfundimtare nga PD dhe PS.

Partia Socialiste nuk e ka përditësuar dhe publikuar programin e saj të ri në faqen zyrtare ku ende ndodhet programi 2017-2021. Mediat vetëm kanë listuar në raportimet e tyre pikat dhe fushat prioritare të programit bazuar në prezantimin e liderit të partisë dhe përfaqësuesve të tjerë të partisë në daljet e tyre publike gjatë fushatës. PS ka bërë publike fushat prioritare nëpërmjet një konference për shtyp, si dhe nëpërmjet publikimit të këtyre fushave në disa media vizive dhe të shkruara. Kryetari i PS, njëkohësisht edhe kryeministër i vendit është shprehur në media se PS nuk ka një program por një plan veprimi dhe se programi do të jetë vazhdim i programit të zbatuar gjatë qeverisjes 8-vjeçare.

Partia Demokratike ka publikuar vetëm fragmente të programit, deri javën e parë të prillit megjithëse lideri i saj ka bërë një dalje publike në të cilën ka deklaruar se është duke paraqitur programin. Në takimet me elektoratin gjithashtu janë përmendur disa fusha prioritare në terma të përgjithshme.

Lëvizja Socialiste për Integrim ka publikuar që në krye të fushatës elektorale një program të përmbledhur me propozimet e saj zgjedhore, në faqen zyrtare sipas fushave prioritare dhe nëpërmjet një video të kryetares së partisë ku sqaron gjithashtu drejtimit kryesore.

Nisma Thurje ka publikuar që në nisje të fushatës programin e saj 'Karta 2020', duke patur një qasje përfshirëse pasi ka ftuar ndjekësit dhe zgjedhësit të jenë pjesë e diskutimeve lidhur me shtyllat bazë dhe nënpikat e përmendura në program.

VLERËSIMI I PROGRAMEVE POLITIKE DHE FOKUSI I TYRE PËR GRATË

Lëvizja Socialiste për Integrim

LSI ka hartuar dhe publikuar sipas afateve programin e saj politik për zgjedhjet parlamentare 2021. Në faqen zyrtare është vendosur programi i emërtuar: Prioritetet zgjedhore të LSI. Në pjesën ballore të faqes zyrtare është theksuar: *Të ndalim shpopullimin, të kthejmë besimin tek shqiptarët dhe rinia, të rrisim ekonominë dhe të garantojmë punësimin e mirëpaguar. LSI do të ndërtojë një Shqipëri ku çdo qytetar, çdo i ri, grua, mësues, mjek, inxhinier, biznesmen, punon me përkushtim, me dinjitet, si në shtëpinë e tij.* Vihet re qasja gjithëpërfshirëse, si edhe vëmendje për gruan në mënyrë të veçantë.

INTEGRIMI GJINOR/QASJA GJINORE NË PROGRAM

Pikat/çështjet në plan/program	Analizë
Pika 2 e Planit Qeverisës <i>Kthimin e ekonomisë në kushtet e tregut të lirë, çlirimin e ekonomisë nga monopolet, për daljen nga recesioni ekonomik si kusht dhe premisë për punësimin, si përparësi e të gjitha politikave ekonomike. Garantimin e ritmeve më të larta të rritjes ekonomike dhe punësimit në mënyrë të veçantë për rininë dhe gruan.</i> ○ Ulje e barrës fiskale ○ Ulje e kostos së jetesës	Plani është hartuar në mënyrë të përmblodhur por gjithëpërfshirëse sa i takon fushave dhe drejtimeve kryesore. Lloji i premtimeve elektorale shprehur nga të gjitha forcat politike.
Pika 6 e Planit Qeverisës <i>Ndalim i shpopullimit dhe mbështetje e gruas dhe familjes, si mbështetje për themelet e shoqërisë</i> (i) Mbështetje për familjet e reja dhe rritje të lindshmërisë - Programi "nga bebja në bebe" duke krijuar fondin për çdo fëmijë të lindur që do t'i kthehet në momentin që rritet dhe riprodhon vetveten: 1000 USD fond fillestar, deri në maturim 25 000 USD.	Kjo lloj mbështetjeje, jo me të njëjtën shumë financiare është ofruar fillimisht vetëm nga bashkia Tiranë. Me një VKM të datës 12.12.2018: "Për përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi) për nënat me foshnja të porsalindura dhe procedurën e dhënies së tij". Sipas kësaj procedure në varësi të verifikimeve të nevojshme, i jepet nënës, menjëherë pas marrjes së Certifikatës së Asistencës në Lindje, në formën e një çeku, të emetuar në emër të nënës dhe të pagueshëm: 35 (tridhjetë e pesë mijë) lekë, 75 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë ose 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë. VKM dhe procedura ekzistuese kanë qasje dhe integrim gjinor. Është një ndihmë e domosdoshme për familjet dhe nënat e reja në vend dhe me ndikim pozitiv në jetën e familjeve dhe nënave

	të reja dhe/ose të vetme. Kërkon një mbështetje buxhetore të konsiderueshme dhe nevojitet planifikim buxhetor afatgjatë.
Pika 6 e Planit Qeverisës ii) Përcaktimi dhe miratimi i minimumit jetik, si referim bazë për ndihmën ekonomike dhe asistencën sociale për çdo familje.	Kjo nismë është e munguar dhe e domosdoshme. Është cilësuar si një nga mangësitë dhe mosrealizimet më të mëdha të të gjitha qeverive të mëparshme. Është një premtin elektorale i cili do të kërkojë rishikimin e ligjeve përkatëse si "Ligji për asistencën sociale" si edhe ripërcaktim të skemës së ndihmës ekonomike. Në program nuk parashtohet një strategji apo shpjegim se si do të realizohet ky premtim elektorale.
Pika 6 e Planit Qeverisës iii) Fuqizimin Ekonomik dhe Social të gruas nëpërmjet programit "Arsim për Punësim", në mënyrë që gratë të emancipohen dhe fuqizohen ekonomikisht.	Arsimimi dhe punësimi ndikojnë në fuqizimin e vajzave dhe grave. Ashtu sikurse është fakt se këto vitet e fundit përqindja e vajzave të arsimuara përkundërt djemve është më e lartë (INSTAT). Nuk shpjegohet shkurtimisht apo në mënyrë të përmblendhur se si do të zbatohet "Arsim për Punësim" dhe si do arrihet fuqizimi.
Pika 6 e Planit Qeverisës (iv) Strategjia për Gruan Sipërmarrëse, e cila do të jetë një paketë masash stimuluese financiare dhe fiskale për arsimimin, kualifikimin, trajnimin, zhvillimin dhe promovimin e nismës private për vajzat dhe gratë.	Integrimi dhe qasja gjinore janë të prekshme e konkrete.
Pika 6 e Planit Qeverisës (v) Fëmijëve të familjeve që përfitojnë nga ndihma ekonomike do t'u ofrohet ushqim falas në çerdhet dhe kopshtet publike.	Është në proces për t'u miratuar Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 në të cilën janë të përfshira të gjitha planet/premtimet e mësipërme. Lidhur me zbatimin e kësaj strategjie ndër vite ka qenë e përcaktuar dhe problematike zbatimi në pjesën më të madhe të masave të propozuara, me përjashtim të atyre masave të cilat kanë qenë të mbështetura kryesisht nga organizatat ndërkombëtare. Të gjitha këto kërkojnë planifikimin e duhur të buxhetimit afatgjatë.

Partia Demokratike e Shqipërisë

Në zgjedhjet parlamentare të Prillit 2021, PD nuk e ka publikuar sipas afateve programin e saj politik. Në faqen web të dedikuar¹ janë listuar prioritetet dhe programi i emërtuar: PROGRAMI SHQIPËRIA FITON. Fushat prioritare janë të vendosura në ballinën e faqes me listimin e 13 fushave si më poshtë:

- i) Shqipëria fiton ekonominë
- ii) Shqipëria fiton shëndetësinë
- iii) Shqipëria fiton Integrimin European
- iv) Grua e Fortë, Shqipëri e Fortë
- v) Plani për Anti-Korrupsionin dhe Klimën e Biznesit
- vi) Shqipëria fiton Arsimin
- vii) Shqipëria fiton Bujqësinë
- viii) Shqipëria fiton Rininë
- ix) Plani për Pronarët
- x) Shqipëria fiton Mirëqenien Sociale
- xi) Shqipëria fiton Turizmin
- xii) Plani për të Përndjekurit Politikë
- xiii) Shqipëria fiton Energjinë

INTEGRIMI DHE QASJA GJINORE NË PROGRAM

Pikat/çështjet në plan/program	Analizë
i) <u>Shqipëria fiton ekonominë:</u> Familja dhe vëmendja ndaj saj janë në qendër të këtij sektori nëpërmjet premtimeve apo angazhimeve të përgjithshme. Më tej flitet për rritjen e pensioneve dhe garantimin e respektit të merituar për të moshuarit. Strehimit dhe ndihmesës për familjet dhe çiftet e reja i kushtohet vëmendje duke premtuar psh. marrjen përsipër të interesave bankare për blerjen e shtëpive të reja.	Janë listuar çështjet prioritare si edhe vihet re një prezantim i përgjithshëm i arsyetuar i programit të paraqitur në faqe. Më pas kalohet në vetën e parë gjë që të lë të kuptosh se bëhet fjalë për një nga fjalimet e kryetarit të partisë. Duke qenë se është vendosur fokusi në familjet apo çiftet e reja kuptohet një vëmendje e shpërndarë dhe e barabartë për të dyja gjinitë. Kur flitet për bujqësinë dhe blegtorinë bëhet përsëri në mënyrë të përgjithshme. Ky sektor mbizotërohet nga puna e papaguar dhe e panjohur e grave dhe për këtë arsye duhet të ishte njohur dhe vlerësuar, psh. duke parashikuar subvencionime apo pagesa të veçanta për gratë dhe vajzat e angazhuara në këtë fushë.
ii) <u>Shqipëria fiton shëndetësinë</u> Ky seksion fillon me theksin e vendosur tek pacienti duke e vendosur atë në qendër të tij. Infrastruktura dhe paga e mjekëve dhe infermierëve janë listuar	Është përdorur qasja e premtimeve elektorale në formatin e fjalimeve siç e kemi theksuar edhe më sipër. Problematikat dhe sfidat e sistemit shëndetësor në Shqipëri në tërësinë e

¹ shqipëriafiton.al

gjithashtu si angazhime. Rritja e numrit të mjekëve, rimbursimi i ilaçeve, riorganizimi i shëndetit publik dhe "Shërimi i vendit" janë premtimet apo angazhimet e tjera.	tij janë të njohura dhe të diskutuara gjerësisht. Nuk ka një plan dhe organizim specifik se cilat janë strategjitë e PD-së për t'u përballur apo zgjidhur këto sfida.
iii) <u>Grua e Fortë, Shqipëri e Fortë</u> Objektivat e reformave të Partisë Demokratike, të përfshira në programin "Shqipëria Fiton me Gruan" kanë në themel të tyre barazinë. Barazi si në kushte, ashtu edhe në mundësi për arsimim, që do të thotë se asnjë vajzë nuk do ta braktisë shkollën prej vështirësive ekonomike, pasigurive, frikës a paragjykitimit. Ndër çështjet e listuara janë: - Barazi në punësim; - Pagë të barabartë për punë të njëjtë; - Sistem promovimi dhe karriere pa diskriminim; - Mundësi për t'u zhvilluar dhe për aftësim profesional për gratë e papuna ose viktimat e dhunës në familje dhe fonde të veçanta për gratë sipërmarrëse; - Barazi në kushte dhe në mundësi në vendimmarrje, që do të thotë se çdo trupë kolegjiale, publike a private, duhet të respektojë parimin e barazisë gjinore; - Fonde të veçanta në dispozicion të grave në jetën publike, veçanërisht për gratë e gazetarisë, aktivistet e shoqërisë civile, etj. - Lufta kundër dhunës ndaj grave e vajzave si sfida për t'u përballur dhe luftuar stereotipet gjinore	Mbështetje dhe fuqizim ekonomik i grave, duke u mundësuar të drejta të barabarta në tregun e punës, duke përfshirë këtu edhe barazinë e pagave mes burrave e grave për punë të njëjtë pa i diskriminuar ato vetëm për faktin se janë gra, duke ua vështirësuar rrugën, duke mos i motivuar, dhe duke i paguar më pak se burrat megjithëse kanë të njëjtin profesion dhe bëjnë të njëjtën punë. Sektorët e përmendur janë gjithëpërfshirës dhe prekin shumë prej temave të identifikuar edhe nga organizatat e shoqërisë civile si prioritetet të rëndësishme lidhur me gratë. PD ka listuar një sërë çështjesh dhe angazhimesh, por nuk ka dhënë një plan të qartë se si do të realizohen këto angazhime. Mungon përfshirja e vetë grave dhe vajzave nga sektorët e listuar.
iv) <u>Plani për Anti-Korrupsionin dhe Klimën e Biznesit</u> Kjo fushë prioritare ka një plan më të qartë masash të cilat do të ndërmerren lidhur me biznesin e madh, të mesëm dhe të vogël, afatet ligjore dhe problematikat. Si hapa që do të ndërmerren janë listuar: Transparenca dhe mirëmenaxhimi, beteja për një treg të lirë dhe sistem anti-korrupsioni si vullnet politik.	Mungon qasja gjinore nëpërmjet analizës së numrit të bizneseve që janë në pronësi të grave apo si do bëhet mbështetja e grave sipërmarrëse.
v) <u>Shqipëria fiton Arsimin</u> Pikat kryesore të planit për arsimin ndër të tjera përfshijnë: - Tekste shkollore të reja falas, për 350 000 nxënës. - Fëmijët e të gjitha familjeve në nevojë përfitojnë paketë shkollore dhe tekste falas gjatë gjithë arsimit parauniversitar. - Program passhkollor dhe ushqim për orët shtesë, e cila do t'ju vijë në ndihmë fëmijëve.	Braktisja e shkollës është trajtuar në fillim të kësaj fushe prioritare duke shpalosur një plan për arsimin i cili përmbledh problematikat e sistemit arsimor në Shqipëri dhe që prek indirekt edhe interesat e vajzave dhe grave. Në këtë seksion është në fokus mirëqenia e familjeve shqiptare, sidomos lidhur me komponentin e rritjes së pagave të mësuesve/seve dhe pedagogëve/eve, profesione të dominuara nga gratë, apo

- Rritje me 60% të pagave të mësuesve. - Ligj i ri për arsimin e lartë. - Rritje pagash me 50%, pedagogëve. - Mbulim i kostove të tarifave të ciklit të parë apo të dytë të studimeve pasuniversitare për çdo student që vjen nga familje me të ardhura të ulëta.	mbështetjes për studentët/et. Gjithashtu në platformë përmendet financimi i dedikuar për gratë dhe vajzat në sektorët me përparësi të lartë, por pa dhënë detaje të mëtejshme lidhur me buxhetin.
vi) <u>Shqipëria fiton bujqësinë</u> Kjo fushë prioritare ndër të tjera thekson vëmendje të veçantë për fermat dhe sipërmarrjet e krijuara nga të rinjtë e diplomuar në arsimin e mesëm profesional dhe atij të lartë në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit, ndër të tjera duke investuar në arsim, shëndet dhe infrastrukturë rrugore në çdo fshat, që çdo familje shqiptare ta ngrejë të ardhmen e saj aty ku jeton.	Nën këtë sektor janë listuar gjithë angazhimet e PD duke i trajtuar sipas problematikave. Vihet re se kostove të përcaktuara i janë bashkangjitur disa prej planeve që lidhen me subvencionimin e fermerëve. <i>Integrimi ose qasja gjinore mungojnë gjithashtu në këtë plan angazhimesh.</i>
Në fushat e tjera prioritare: <i>Shqipëria fiton Rininë, Planin për Pronarët, Shqipëria fiton Mirëqenien Sociale, Shqipëria fiton Turizmin, Planin për të Përmjekurit Politikë dhe Shqipëria fiton Energjinë</i>, përdoret e njëjta qasje: listimi i problematikave kryesore për secilën fushë, angazhimet përkatëse një pjesë e mirë e të cilave janë të përgjithshme, me pak ose aspak referime statistikore dhe buxhetore. Integrimi gjinor mungon në shumicën e fushave prioritare. Nga ana tjetër një seksion i veçantë ka përfshirë në angazhimet politike të gjitha fushat e listuara si prioritare nga kjo parti.	

Partia Socialiste e Shqipërisë

Analiza e plan veprimit të PS është bazuar nëpër artikuj në disa media vizive dhe të shkruara, për shkak të mungesës së një publikimit zyrtar të këtij plani veprimi nga PS. Disa nga temat që janë adresuar në media kanë qenë si më poshtë.

INTEGRIMI DHE QASJA GJINORE NË PROGRAM

Pikat në plan program	Analizë
Programi ekonomik, sipas deklaratave në media: - Deri në vitin 2025, paga minimale të mund të rritet deri në 40 mijë lekë në muaj. Paga mesatare bruto në rang vendi do të shkojë në 85 mijë lekë bruto; - Fondi i mbështetjes për sipërmarrjet e reja start-up do të 5-fishohet; - Ligj të ri të start up-eve në fushën e inovacionit me objektiv të qartë nxitjen e ideve inovatore dhe zero taksa për dy vitet e para që do t'i japë impakt zhvillimit të sipërmarrjeve nga të rinjtë. - Do të krijohen programet "Inovacion dhe ekselencë në manifakturë" dhe "Inovacion dhe ekselencë në IT" - Dyfishimi i fondit për kreditë e buta për	Mungon një qasje gjinore në prezantimin e nismave me karakter ekonomik. Tërthorazi disa prej ndërhyrjeve të parashikuara adresojnë çështje të grave, si rritja e pagës minimale duke qenë se gratë punojnë në sektorët më të keqpaguar të ekonomisë, apo dyfishimi i fondit për kreditë e buta për strehimin e familjeve të reja, duke shtuar kështu mundësitë për kredi të buta edhe për gratë familjare.

strehimin e familjeve të reja.	
Arsimi Për këtë sektor parashikohen: - rritje pagash për mësuesit (i kemi rritur deri në 32%, në mandatin tonë të tretë do t'i rrisim 40%); - Libra falas për të gjithë nxënësit e arsimit para-universitar. - Subvencionim me pagesë me çerdhet dhe kopshtet private, për subvencionimin e pagesës në rastet e pamundësisë së gjetjes së vendeve të lira në strukturat shtetërore	Mungon një qasje gjinore në prezantimin e nismave lidhur me arsimin. Gjithsesi, veprimet e parashikuara adresojnë problematika që prekin kategorinë e grave mësuese (pagat e ulëta) dhe kostot lidhur me pagesën e çerdheve dhe kopshteve, shqetësim ky sidomos për familjet me të ardhura të ulëta, si dhe gratë kryefamiljare, etj.
Shëndetësia: - Rimodelimi i financimit publik për shëndetësinë, modernizimin e sistemit shëndetësor. - 100 qendra shëndetësore dhe ambulanca të rehabilituara deri në vitin 2024. - Vendosja në punë e 10 qendrave model të mjekësisë familjare. 4 spitale rajonale të transformuar në qendra reference diagnostikuese. - 6 spitale rajonale me shërbim të ri të obstetri gjinekologjisë dhe pediatriisë. - 2 spitale universitare të obstetri gjinekologjisë.	Investimet në sektorin e shëndetësisë, duke marrë parasysh edhe situatën e pandemisë që e ka vënë akoma më shumë në fokus këtë sektor, ndërkohë që evidentuar ndjeshëm mangësitë e sistemit, kanë bërë që shëndetësia të jetë një fjalë kyç në fushatën elektorale të PS, duke vënë fokusin tek investimet që po planifikohen. Një nga investimet është i lidhur drejtpërdrejt me shëndetin riprodhues, më së shumti atë të grave.
Infrastruktura - Brenda gjashtë muajve të ardhshëm, vendosje në punë e aeroportit të Kukësit. - Brenda 2021, përfundimi i Rrugës së Arbrit. Ngritja e Aeroportit të Vlorës. Përfundimi i linjës hekurudhore Tiranë-Rinas-Durrës. Linja e re hekurudhore Pogradec-Korçë-Greqi - Përfundimi i akseve Ballëdren-Milot dhe Milot-Fier. Tuneli i Llogarasë".	Planet e veprimit lidhur me infrastrukturën dhe mënyra si ato shtrohen gjatë fushatës nuk kanë një qasje gjinore.
Manifaktura - Lehtësim i procedurave të rekrutimit me 3 muaj integrim të rimbursuar për çdo punësim të ri. - Nxitje për transformimin e proceseve të prodhimit. - Lehtësim barrës tatimore dhe kompanitë do të kenë më shumë likuiditet. - Krijim i një fondi kreditimi prej 10 milionë eurosh për manifakturën.	Planet e veprimit lidhur me manifakturën nuk kanë një qasje gjinore.
Bujqësia: - 16 milionë dollar deri në vitin 2025 për të mbështetur më shumë kultura të mbjelljes. - Akses në programin IPARD III me fond financimi 166 milionë euro. - Ulje TVSh-në për grumbulluesit në 6%. - Dyfishimi i numrit të bagëtive të imta nga 2 milionë në 4 milionë.	Ndërkohë që flitet për investime në disa nyje të këtij sektori, qasja gjinore është tërësisht e munguar, duke marrë parasysh numrin shumë të lartë të grave rurale që quhen 'të vetëpunësuar' nga ana statistikore në vendin tonë. Realizimi i premtimit të përsëritur nëpër fushata ndër vite, për furnizim me ujë 24 orë në

- Furnizim me ujë 24 orë për të gjithë qytetet e Shqipërisë, përfshi 90% të zonave rurale	qytet e fshat, përmirëson ndjeshëm cilësinë e jetesës së qytetarëve, sidomos të vajzave e grave që janë më të angazhuara në role riprodhuese krahasimisht me djemtë e burrat.
Turizmi - Zona të reja të zhvillimit turistik, në total 6 zona. - Agroturizmi do të mbështetet jo vetëm financiarisht, por edhe me harta, rrugë, infrastrukturë lokale, promovim unik. - Paketë unike kombëtare për promovimin ndërkombëtar të destinacioneve, paketë në të cilën shteti shqiptar do të investojë 10 milionë euro çdo vit. - Shteti shqiptar do të subvencionojë dhe operatorët turistikë.	Turizmi është një sektor ku roli i grave është kyç, ndërkohë që mbetet shpesh i padukshëm në nivel politikash. Edhe në shtjellimin e plan veprimit për këtë sektor, vihet re që mungon qasja gjinore.

Nisma Thurje

Nisma Thurje ka publikuar që në nisje të fushatës programin e saj 'Karta 2020', me 4 shtylla bazë dhe nënpika të përmendura në program.

INTEGRIMI DHE QASJA GJINORE NË PROGRAM

Pikat në plan program	Analizë
1) Krijimi i kushteve të barabarta për progres ekonomik dhe social - Kjo shtyllë prek katër tematika: Zhvillimin Ekonomik; Politikat Rregullatore; Administrimi Publik i pasurisë natyrore dhe Politikat Sociale. <u>Tek politikat sociale veçojmë:</u> - Çdo familje shqiptare duhet të përfitojë një të ardhur bazë, në natyrë, në energji elektrike dhe ujë të pijshëm, si elemente bazë të të drejtës së jetës. - Duhet stimuluar krijimi i skemave sociale që garanton se shtresat në nevojë përfitojnë nga përdorimi ekonomik i hapësirës publike të qyteteve. - Lehtësim nga barra fiskale të bizneseve të vogla dhe start-upeve me qëllim lehtësimin e tranzicionit nga papunësia drejt punësimit. - INSTAT të nxjerrë në mënyrë periodike Indeksin e Minimumit Jetik, ku përcaktohen të ardhurat e nevojshme për të pasur minimumin jetik në Shqipëri. - Ndiurma ekonomike për familjet në nevojë duhet të jetë e barabartë me minimumin jetik.	Kjo shtyllë e partisë 'Nisma', ashtu si dhe shtyllat e tjera të programit nuk ka një qasje gjinore, por është ajo pjesë e programit që prek më nga afër problematikat e grave, sidomos atyre që jetojnë në varfëri, duke vënë fokusin tek problematika të ngritura ndër vite nga shoqëria civile, si përcaktimi i minimumit jetik dhe përditësimi i vazhdueshëm i këtij vlerësimi, apo njëjësimit i ndihmës ekonomike (ku përfituese janë më shumë gra se burra) me minimumin e vlerësuar jetik. Gjithashtu adresimi i një problematike si sigurimi i të ardhurave bazë në natyrë si energji dhe ujë si element bazë të jetesës, prek indirekt cilësinë e jetës të shumë grave që jetojnë në varfëri ekstreme.

2) Fuqizimi politik i qytetarëve për të garantuar funksionimin e demokracisë – nëntemat e kësaj shtylle janë: Fuqizimi i popullit dhe ushtrimi i sovranitetit në mënyre direkte; Demokratizimi i partive politike dhe Garantimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. 3) Reformimi i shtetit për të garantuar sovranitetin e popullit - nëntemat e kësaj shtylle janë: Rikthimi në traditën e jurisë në sistemin gjyqësor dhe Decentralizimi i pushtetit dhe fuqizimi i mekanizmave të balancës dhe kontrollit kushtetues. 4) Riorganizimi shoqëror - promovimi i solidaritetit social mes shqiptarëve	Këto tre shtylla të programit kanë një qasje gjithëpërfshirëse për të gjithë qytetarët dhe adresojnë të gjitha pabarazitë në përgjithësi.
--	--

FORCAT POLITIKE DHE GRATË PËRGJATË FUSHATËS ELEKTORALE

Dy forcat kryesore politike të vendit, PD dhe PS kanë përfshirë gjatë pjesës së parë të fushatës (deri në fillim të muajit prill) vetëm pjesërisht dhe jo thelbësisht gruan dhe çështjet e barazisë gjinore. Gjatë fjalimeve përgjatë fushatës së PD-AN, sidomos gjatë intensifikimit të saj është vënë re një theks i shtuar sa i takon përfshirjes së grave dhe vajzave. Prania e tyre është vënë re edhe gjatë fjalimeve elektorale.

Takime të dedikuara me gratë dhe vajzat kanë qenë më intensive veçanërisht gjatë muajit prill nga 2 forcat kryesore politike PD dhe PS. PD ka qenë më aktive me aktivitete elektorale me gratë, lëvizje kjo që është reflektuar edhe në prezantimin e një pike të veçantë në program që ka në fokus të drejtpërdrejtë interesat dhe nevojat e vajzave e grave. PS ka pasur një qasje më pak të segreguar me elektoratin e saj, gjithsesi herë pas herë ka pasur takime elektorale me vajza e gra dhe më shpesh më të rinj e të reja. Disa shembuj aktiviteteve elektorale me gra, organizuar nga PD dhe PS:

- PD: 20 prill 2021, takim me gratë në Tiranë. Në këtë takim elektoral u është lënë hapësirë vetë vajzave dhe grave, është folur për problematikat e tyre si arsimi, pagat e barabarta, gratë sipërmarrëse, dhuna me bazë gjinore etj,
- PD: 19 prill 2021 në Dibër, takim i kryetarit me profesioniste dhe studentetë reja,
- PD: 12 prill 2021, takim elektoral me profesioniste të fushave të ndryshme,
- PD: 11 prill 2021, takime me gratë në zona të ndryshme
- PD: 14 mars 2021, bashkëbisedim i kryetarit me zonjat candidate për deputete në qarkun e Elbasanit, si dhe gra përfaqësuese në fusha të ndryshme në Elbasan
- PD: 12 Mars 2021, Prezantimi i Partisë Demokratike me gratë në Durrës
- PS: 16 prill 2021, takim elektoral me vajzat dhe gratë e Tiranës ku i është dhënë hapësirë hapjes së takimit nga një vajze e re si dhe, ku u promovuan disa figura të

vajzave dhe grave, duke mos folur me terma konkretë se çfarë do të bëhet sipas programit për gratë dhe vajzat.

- PS: 12 prill 2021, takim me gratë e Elbasanit
- PS: 7 prill 2021, takim me gra të biznesit në Përmet.

PËRFUNDIME

Partitë politike në vend vazhdojnë të përballen me sfidën e sigurimit të pjesëmarrjes së barabartë dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në të gjitha nivelet. Integrimi gjinor në programet politike të partive mbetet gjithashtu një çështje që pavarësisht përmirësimeve nga një proces zgjedhor në tjetrin, nuk arrin akoma të reflektojë nevojat e vajzave dhe grave në vend.

Organizata të shoqërisë civile që punojnë çdo ditë për të mbrojtur e promovuar të drejtat e vajzave dhe grave, kanë identifikuar disa çështje jetësore që prekin më nga afër jetën dhe dinjitetin e grave dhe të vajzave në vendin tonë. Këto prioritete të identifikuara dhe listuara si më poshtë, u janë komunikuar me shkrim edhe forcave kryesore në vend gjatë muajit shkurt 2021. Ndër çështjet më kryesore të identifikuara kanë qenë:

- Respektimi i kuotës gjinore në të gjitha hallkat vendimmarrëse të subjekteve partiake, duke respektuar kështu parimet e barazisë gjinore në politikëbërje e vendimmarrje.
- Prioritizimi i buxhetit për programin e strehimit social dhe rishikimi i kuotave të ndihmës ekonomike për të gjitha grupimet më pak të favorizuara, me fokus të veçantë gratë, sidomos ato në nevojë: viktimat e dhunës me bazë gjinore, gratë kryefamiljare, gratë e varfra, gratë me nevoja të veçanta, gratë e komunitetit Rom dhe Egjiptian, gratë e moshuara, etj.
- Politikat dhe programet e punësimit dhe vetëpunësimit të kenë në vëmendje mbështetjen e grave vulnerabël, me fokus të veçantë grupet e sipërpërmendura.
- Prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planit Kombëtar të Veprimit si edhe legjislacioni përkatës (me finalizimin e draftit 2021 – 2030), të jenë udhëzuesi kryesor i nismave që adresojnë interesat dhe nevojat e vajzave dhe grave në Shqipëri.

Rrjeti i Fuqizimi të Gruas në Shqipëri - AWEN dhe 10 organizatat anëtarë që punojnë në të gjithë vendin, konsiderojnë që adresimi i këtyre çështjeve përbën jo thjesht një vlerë të shtuar, por një kusht të domosdoshëm për një program partiak gjithëpërfshirës dhe që ka në fokus zhvillimin e qendrueshëm dhe integrimin e vendit në Bashkimit Evropian dhe zbatimin e standardeve Kombëtare e Ndërkombëtare të mishëruara në kuadrin ligjor dhe të politikave në Shqipëri.

Në përfundim, në këto zgjedhje parlamentare vëmë re se jo të gjitha forcat politike kryesore kanë një qasje të ndjeshme gjinore. LSI duket të ketë një qasje gjinore më të kujdesshme krahasimisht me partitë e tjera përgjatë gjithë programit të saj, në çdo sektor të parashtruar në program. Nga ana tjetër, PD i ka kushtuar një pikë kryesore të programit problematikave kyçe që prekin gratë, por pa e shtrirë këtë qasje përgjatë gjithë pikave të tjera të programit të propozuar. PS, partia që hyn në këto zgjedhje parlamentare nga pozita e forcës politike qeverisëse është mjaftuar me prononcime mediatike që përmendin sporadikisht problematikat e grave në media, por pa u thelluar në detajimin e tyre në një program mirëfilli me qasje gjinore. Së fundmi, Nisma Thurje, duke pasur një qasje barazimtare ndaj gjithë grupeve sociale të disavantazhuara, nuk ka bërë dallim për vajzat dhe gratë në programin e saj, por ka ruajtur një gjuhë që synon barazinë në çdo prioritet social-ekonomik të listuar në program. Kjo qasje dukshëm eviton diskriminimin pozitiv të grave, por është një praktikë që e vlerësojmë të parakohshme në një vend si Shqipëria, ku pabarazitë gjinore janë shumë të thella dhe kanë nevojë të adresohen me politika ndihmëse e të posaçme.

Ka akoma shumë punë për të bërë që çështjet e lidhura me vajzat e gratë të jenë të integruara në komponentet e çdo plani apo programi partiak. Vetëm nëse lentet gjinore përdoren në çdo angazhim e nismë politike e ekonomike në vend mund të bëhet e mundur që treguesit gjinore të përmirësohen dhe që vajzat e gratë shqiptare të jetojnë një jetë të denjë.